TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

I. *Seminari i së premtes*
II. *Punë kërkimore të sapopërfunduara*
III. *Materiale diskutimi në proces*
IV. *Artikuj*
V. *Aktivitete të tjera*

I. SEMINARI I SË PREMTES

Disa nga materialet e prezantuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, kanë pasur në fokus të tyre çështje të ndryshme si: faktorët makroekonomikë të rrezikut të kredisë; qëndrueshmërinë fiskale në Shqipëri; zhvillimet e tregjeve financiare në Evropë; dhe (jo)racionalitetin e pritjeve inflacioniste në Shqipëri. Në vazhdim shpaloset një përmbledhje e temave të prezantuara.

"NDIKIMI I FAKTORËVE MAKROEKONOMIKË NË RREZIKUN E KREDISË: RASTI I SHQIPËRISË, 2000-2014", NGA MERI PAPAVANGJELI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Kriza e viteve të fundit tregoi se brishtësia e sistemit financiar buron jo vetëm nga faktorë endogjenë, por është gjithashtu pasojë e zhvillimeve që ndodhin në mjedisin makroekonomik dhe financiar. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë lidhjen që ekziston midis faktorëve që karakterizojnë mjedisin makroekonomik, të tillë si: Prodhimi i Brendshëm Bruto, Indeksi i Çmimit të Banesave, kursi i këmbimit, norma e interesit, totali i kredisë dhënë sektorit privat dhe rreziku i kredisë ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar shqiptar. Metodologjia e përdorur përbëhet nga vlerësimi i një modeli të korrektimit të gabimit VECM, përmes së cilit studiohen marrëdhëniet afatshkurtra dhe afatgjata midis këtyre treguesve dhe vlerësohet shpejtësia me të cilën secili prej tyre shkon drejt ekuilibrit afatgjatë.

"MBI ZHVILLIMET E TREGJEVE FINANCIARE NË EVROPË DHE MBI PORTOFOLIN E INVESTIMEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË SHQIPËRI, KRAHASUAR ME AUSTRINË", NGA ELVIS PONARI, PËRFAQËSUES RAJONAL I "UNIQA INSURANCE GROUP AG"

Prezantimi u përqendrua mbi zhvillimin e tregjeve financiare në Evropë, ilustruar me të dhëna dhe statistika nga bota e sigurimeve për Evropën në krahasim me Shqipërinë, si dhe u analizuan portofolet e investimeve të shoqërive të sigurimit në Austri dhe Shqipëri. Përfaqësuesi i

UNIQA, ndër të tjera, ofroi një përshkrim të problemeve të tregut të sigurimeve në Shqipëri, si: mungesa e diversifikimit, konkurrenca e ulët, infrastruktura e varfër dhe klima e dobët për inovacione.

"QËNDRUESHMËRIA FISKALE DHE VLERËSIMI I VULNERABILITETEVE FISKALE NË SHQIPËRI" , NGA ANJEZA JAHAJ DHE IRIS METANI, DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Ky punim i hartuar në trajtën e një manuali teorik dhe praktik, bazat e të cilit ngrihen mbi identitete makro, ofron një aparat për të analizuar qëndrueshmërinë e borxhit publik në Shqipëri. Materiali synon të përmirësojë kapacitetin analizues për vlerësimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik dhe të identifikojë rreziqet ndaj të cilëve ekspozohet aftësia paguese e qeverisë. Manuali mbi të cilin është strukturuar analiza, ka si bazë teorike dhe format përdorimi materialet e FMN-së (Fondit Monetar Ndërkombëtar) mbi këtë temë. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së borxhit publik në Shqipëri, sipas kësaj përqasjeje, kryhet nëpërmjet një ushtrimi, i cili parashtron një skenar bazë për trajektoret e projektuara të borxhit publik dhe të nevojave për financim bruto në raport me PBB-në. I shtrirë në një horizont kohor 5-vjeçar, skenari bazë plotësohet me skenarë alternativë, për goditje të caktuara rreziku. Gjithashtu, analiza plotësohet edhe me vlerësimin e rreziqeve të lidhura me likuiditetin dhe aftësinë paguese të agjentit fiskal me origjinë nivelin e borxhit publik, strukturën e tij, si dhe nevojat për financim.

"PRITJET INFLACIONISTE NË SHQIPËRI: RACIONALE APO JO? – VLERËSIME NGA VROJTIMET", NGA EVELINA ÇELIKU, GENTI HASHORVA DHE MERITA TOSKA, DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Rëndësia e pritjeve të inflacionit për politikën monetare kërkon analizën e natyrës së tyre: racionale apo adaptive? Kjo është thelbësore veçanërisht në regjimin e inflacionit të shënjestruar zbatuar në vitet e fundit nga Banka e Shqipërisë. Kjo analizë është realizuar mbi seritë e pritjeve inflacioniste nga vrojtime të BSH-së për periudhën 2003T2-2015T1. Seritë e pritjeve cilësore janë kuantifikuar duke përdorur përqasje të ndryshme probabilitare dhe të balancës, krahas atyre sasiore. Analizat statistikore tregojnë se pritjet e vrojtuara inflacioniste mbartin informacion të dobishëm në lidhje me drejtimin e presioneve të ardhshme inflacioniste. Rezultatet e testimit të racionalitetit konfirmojnë natyrën mikse të pritjeve, ndërkohë që deri në fillim të vitit 2009 ato rezultonin plotësisht adaptive. Ndonëse pritjet vijojnë të dominohen nga natyra adaptive, disa prej tyre kanë fituar veti racionale ndër vite. Zgjatja e serive kohore të pritjeve, përmirësimet në kuantifikimin e tyre dhe transparenca më e lartë në komunikimin e politikës monetare, kanë ndikuar evidentimin e cilësive racionale. Në termat e kontributit të racionalitetit të pritjeve të inflacionit në parashikimin e tij, vlerësimet ekonometrike sugjerojnë jo vetëm rritjen e vlerës së parametrit paraprijës të inflacionit, por edhe madhësinë e tij, ndërkohë që në kalibrimin aktual ky parametër ka vlerë minimale.

II. PUNË KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

"NDËRMARRJA E RREZIKUT BANKAR DHE KONKURRENCA NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR", NGA ELONA DUSHKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Investigimi i lidhjes ndërmjet konkurrencës dhe rrezikut bankar është një çështje e rëndësishme për stabilitetin financiar dhe për gjithë ekonominë në tërësi. Duke përdorur të dhëna bankare për Shqipërinë, materiali teston empirikisht lidhjen ndërmjet rrezikut bankar dhe konkurrencës, gjatë periudhës 2004-2014. Gjetjet e studimit konfirmojnë pikëpamjen "konkurrencë-brishtësi" për rrezikun e kredisë totale (dhe të asaj akorduar në valutë të huaj), ku fuqia më e madhe e tregut shoqërohet me rrezik më të ulët. Gjithashtu, studimi mbështet pikëpamjen "konkurrencë-stabilitet" për kreditë e këqija në monedhë vendase. Autorja gjen se pas krizës, lidhja ndërmjet rrezikut të kredisë totale (dhe në valutë të huaj) dhe konkurrencës është jolineare.

"EFEKTET MAKROEKONOMIKE TË PËRÇIMIT TË POLITIKËS MONETARE NËPËRMJET QASJES SË KUFIZIMIT TË SHENJËS, NË RASTIN E SHQIPËRISË"[1], NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Bankat qendrore, për t'iu kundërvënë rreziqeve të krizës financiare globale, kanë ulur normat e interesit në nivele historike. Kjo politikë është shoqëruar edhe me ndjekjen e politikave të lidhura me bilancin kontabël të bankave qendrore. Këto politika kanë pasur për qëllim të rivendosin besimin në sistemin financiar, uljen e riskut bankar dhe të kredisë sovrane, rimëkëmbjen ekonomike dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Ky punim analizon mekanizmin e transmetimit të politikës monetare në Shqipëri, gjatë periudhës 2002M01- 2014M12. Pyetja kryesore trajton efektet makroekonomike të përçimit të një goditjeje të politikës monetare, përfaqësuar nga ndryshimet në normën bazë të interesit dhe ndryshimet e mundshme të politikave të bilancit kontabël. Analiza bazohet në një model strukturor të vektorëve autoregresivë për ekonominë shqiptare, i cili përfshin identifikimin sipas qasjes Choleski dhe asaj të kufizimit të shenjës.

[1] *Ky studim është kryer në kuadër të programit Bilateral Assitance and Capacity Building for Central Banks, midis Bankës së Shqipërisë dhe Graduate Institute Geneva e SECO.*

III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

"PËRCAKTUESIT MIKRO DHE MAKROEKONOMIKË TË MARZHIT BANKAR NË SHQIPËRI (2002-2014)" NGA ERALDA LEKA, DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, DHE MERI PAPAVANGJELI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Duke përfshirë për herë të parë tregues makroekonomike në analizën empirike me të dhëna panel për bankat tregtare në Shqipëri, për periudhën 2002 – 2014, ky studim synon të hedhë dritë mbi faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave. I konsideruar gjerësisht si një indikator i mirë i nivelit të eficiencës së ndërmjetësimit bankar, madhësia e marzhit ndihmon për të perceptuar asimetritë në treg dhe kostot e transmetuara te klientët. Qëllimi i punimit është të kontribuojë në hartimin e politikave monetare që rrisin eficiencën e tregut bankar dhe që garantojnë mirëfunksionimin e tij.

"SI NDIKON HAPJA (TREGTIA ME JASHTË) NË PERFORMACËN E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI DHE EVROPËN JUGLINDORE", NGA ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Duke shfrytëzuar të dhënat për bizneset nga pyetësori i ndërmarrjeve të Bankës Botërore (Enterprise Survey, World Bank), materiali krijon një panel të dhënash për Shqipërinë dhe vendet e rajonit. Qëllimi i këtij materiali është të studiojë ndikimin që ka ekspozimi tregtar i ndërmarrjeve në performancën e tyre në tregues të ndryshëm si: produktiviteti, madhësia, rritja ekonomike e tyre, inovacioni etj. Ky material synon të ofrojë një analizë të detajuar të ndërmarrjeve ekonomike në vend, si dhe situatën në të cilën gjenden sipërmarrjet shqiptare krahasuar me ato të vendeve të rajonit. Analizimi paraprak i të dhënave sugjeron se sipërmarrjet e ekspozuara në tregtinë me jashtë (import/eksport) performojnë më mirë se ndërmarrjet që operojnë vetëm në tregun e brendshëm.

"VLERËSIMI I DENSITETEVE ME KUSHT, NJË PËRGJITHËSIM I DENSITETIT ME KUSHT. APLIKIMI PËR TË DHËNA EKONOMIKE", NGA ALTIN TANKU DHE KLITI CECA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Materiali ka për qëllim të ofrojë një përgjithësim të natyrshëm të konceptit të densitetit me kusht, për densitetet e vlerësuara shumëdimensionale. Në material është dhënë një përgjithësim i përkufizimit të densitetit shumëdimensional dhe i densitetit me kusht, një bashkësi–rezultat autentik. Këto rezultate janë aplikuar mbi një bazë të dhënash me frekuencë tremujore të ekonomisë amerikane që shtrihet në periudhën 1959-2014, për 5 variabla kryesorë makroekonomikë. Janë gjeneruar rezultatet përkatëse për 4 nënperiudha (që i korrespondojnë 4 guvernatorëve të ndryshëm) të serive kohore.

"PARAMETRIZIMI NË KUSHTET E VLERËSIMIT TË DENSITETEVE – NJË APLIKIM PËR VARIABLAT EKONOMIKE", NGA ALTIN TANKU DHE KLITI CECA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material diskutimi ka për qëllim të japë mënyra parametrizimi në modelet e ngritura mbi konceptin e densiteteve të vlerësuara. Në të është dhënë një përkufizim i përgjithësuar i konceptit të parametrizimit, është studiuar gjithashtu literatura mbi parametrizimin e modeleve stokastike, si dhe janë përcaktuar skenarët potencialë për metodologjinë e parametrizimit që do të ndiqet në material. Konkretisht, autorët propozojnë teknika konkrete optimizmi në hapësira funksionale. Janë vlerësuar densitetet 5-dimensionale bazuar në dy baza të dhënash makroekonomike (një për ekonominë shqiptare dhe një për ekonominë amerikane). Mbetet për t'u realizuar aplikimi i skenarëve të përzgjedhur për gjenerimin e matricës së parametrave dhe përshkrimin e marrëdhënieve të treguesve ekonomikë që rrjedhin prej tyre.

"NJË SUGJERIM I THJESHTË PËR IMPLEMENTIMIN E METODËS IRB NËN BASEL II", NGA LINDITA VRIONI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ndërkohë që bankat kanë njohur nevojën për metoda më të sofistikuara në matjen e rrezikut të kredisë, si përgjigje e rritjes së kompleksitetit dhe globalizimit të aktivitetit të tyre, edhe bankat më të mëdha në sistemin bankar shqiptar nuk kanë mundur të regjistrojnë numër të mjaftueshëm të falimentimeve (defaults) dhe humbjeve nga klasa të caktuara aktivesh, që të mundësohet vlerësimi i parametrave të një modeli të brendshëm për matjen e rrezikut të kredisë (sipas IRB).

Materiali propozon kryerjen e një procesi tranzitor ku disa nga parametrat e nevojshëm mund të vlerësohen dhe të përcaktohen, duke përdorur të dhënat e gjithë sistemit bankar të grumbulluar në Regjistrin e Kreditit (tashmë prej pesë vjetësh) dhe ndërtimin e një modeli të mbikëqyrjes për matjen e rrezikut të kredisë. Modeli do të japë informacion të vlefshëm në vlerësimin e kujdesshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, dhe në të ardhmen do të duhet të përdoret për t'i dhënë vlerë modeleve të bankave individuale.

"IMPAKTI I PRIVATIZIMIT NË PERFORMANCËN E NDËRMARRJEVE NË EVROPËN QËNDRORE DHE LINDORE", NGA MARGARITA TOPALLI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material ka për qëllim t'i përgjigjet një debati të gjerë që ekziston në literaturë mbi efektet e privatizimit (kalimit nga një ndërmarrje shtetërore në një ndërmarrje private) në performancën e ndërmarrjeve, për tregues si: ndërmarrja, produktiviteti etj. Ai mbështetet në një studim të Frydman et al.(1999), i cili studion efektet e privatizimit në vendet e tranzicionit. Baza e të dhënave është mbledhur nga EBRD (Enterprise Survey), e cila përfshin të dhëna mbi performancën, punësimin, llojin e pronësisë etj.

"ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR, AKSESI DHE RRITJA EKONOMIKE", NGA ENDRIT YZEIRAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material synon të analizojë rritjen dhe zhvillimin e sektorit financiar në Shqipëri dhe të hulumtojë efektin e saj në ekonominë tonë. Literatura për vendet në zhvillim ka evidentuar raste të shumta kur zhvillimi i sektorit financiar mund të humbasë efektin. Në ndryshim nga vendet e zhvilluara, në vendet në zhvillimi

ekzistojnë disa aspekte më specifike të rritjes së sistemit financiar që paraqesin interes. Ky material do të ndalet në disa prej tyre për ekonominë tonë. Më konkretisht, rritja e shpejtë e sektorit financiar në gjysmën e dytë të dekadës së shkuar, më e shpejtë edhe se rritja ekonomike, është një nga aspektet për të cilat haset debat në literaturë.

Po ashtu, aksesi në sistemin financiar nuk duket të ketë qenë i shpërndarë në të gjitha shtresat e popullatës. Përqendrimi i shumtë i sistemit financiar në disa sektorë dhe shtresa të ekonomisë do të sillte një ulje të eficiencës së tij. Metodologjia e përdorur do të përbëhet nga teknikat standarde ekonometrike për seritë kohore.

IV. ARTIKUJ

Në këtë rubrikë do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të disa artikujve dhe materialeve të publikuara nga Banka e Shqipërisë apo banka të tjera qendrore, gjatë periudhës janar-qershor 2015, për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi temat kërkimorë shkencorë të publikuar gjatë kësaj periudhe.

"PËRDORIMI I RRJETEVE NEURALE ARTIFICIALE NË PARASHIKIMIN E KURSIT TË KËMBIMIT", NGA BLERINA VIKA, FAKULTETI EKONOMIK, UNIVERSITETI I TIRANËS; KOZETA SEVRANI, FAKULTETI EKONOMIK, UNIVERSITETI I TIRANËS; DHE ILIR VIKA, BANKA E SHQIPËRISË

Ky artikull kontribuon në literaturën e rrjeteve neurale artificiale, duke vlerësuar sa të fuqishme e të përdorshme mund të jenë ato si një mjet në procesin e vendimmarrjeve ekonomike. Autorët shqyrtojnë dobishmërinë e Rrjeteve Autoregresive Jolineare (NAR) në krahasim me modelet ARIMA, të cilat përdoren zakonisht si referencë në parashikimin e kursit të këmbimit. Për demonstrim, autorët përdorin kursin e këmbimit të dollarit ndaj euros, si një aset mjaft të luhatshëm dhe shumë të tregtuar në tregjet financiare ndërkombëtare, e megjithatë mjaft të kontestuar në punët akademike, për shkak të devijimeve shpesh të mëdha të tij nga nivelet ekuilibër të sugjeruara nga teoritë ekonomike. Materiali tregon - edhe pse përmes një aplikimi modest - se modelet e rrjeteve neurale mund të shërbejnë si vlerë e shtuar e ndoshta mund të lënë pas modelet tradicionale në parashikimin e kursit të këmbimit. Rezultatet pohojnë se rrjeti autoregresiv jolinear arrin të mposhtë vazhdimisht modelin ARIMA (dhe ecjen rastësore) në parashikimin statik të kursit të këmbimit.

"INDEKSI LERNER-TREGUES I FUQISË SË TREGUT TË BANKAVE NË SHQIPËRI", NGA ELONA DUSHKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE, REVISTA EKONOMIKE E BANKËS SË SHQIPËRISË, GJASHTËMUJORI I 2015

Konkurrenca në sektorin bankar ka qenë dhe mbetet një çështje me mjaft interes, jo vetëm për rëndësinë që ka për sistemin bankar dhe atë financiar, por edhe për ndikimin në ekonomi në

tërësi. Vitet e fundit i është kushtuar më së shumti vëmendje lidhjes që ekziston midis konkurrencës së sistemit bankar dhe rrezikut të sistemit bankar, për vetë ndikimin që ajo ka në sektorin real dhe atë financiar [Beck, (2008), Beck et al, (2012)]. Testimi i këtyre lidhjeve dhe marrja e rezultateve sa më të qëndrueshme kërkon fillimisht matjen dhe vlerësimin sa më të saktë të konkurrencës. Qëllimi i këtij artikulli është matja e konkurrencës së bankave që veprojnë në Shqipëri, bazuar në përqasjen jostrukturore. Vlerësimet e marra tregojnë se gjatë periudhës 2004-2014, konkurrenca e bankave në Shqipëri, matur me anë të indeksit Lerner, është midis konkurrencës së plotë dhe asaj monopolistike.

"TABELAT SAM TË SHQIPËRISË: STRUKTURA DHE MULTIPLIKATORËT", NGA ENIAN ÇELA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE, REVISTA EKONOMIKE E BANKËS SË SHQIPËRISË, GJASHTËMUJORI I 2015

Tabelat e kontabilitetit social përfshijnë tërësinë e transaksioneve në ekonomi gjatë një viti. Në këtë artikull janë prezantuar statistikat më të fundit të llogarive kombëtare që lidhen me tabelat burime-përdorime dhe input-output, në rastin e Shqipërisë. Këto statistika raportojnë tërësinë e transaksioneve të zhvilluara gjatë një viti për ekonominë tonë, në periudhën 2009-2011, në terma nominalë. Në këtë material, përshkrimi i përgjithshëm i karakteristikave të tre tipave të tabelave është shoqëruar me llogaritjen e multiplikatorëve të prodhimit, të ardhurave, importeve dhe produktit të brendshëm për 25 sektorët e përfshirë në statistika. Të njëjtët multiplikatorë janë llogaritur për komponentët e kërkesës agregate. Së fundi, janë përshkruar disa nga karakteristikat e përgjithshme dhe disa rreziqe strukturore sipas këtyre statistikave për ekonominë.

"MULTIPLIKATORËT FISKALË NË KUFIRIN E POSHTËM ZERO: ROLI I INERCISË SË POLITIKËS", NGA TIMOTHY S. HILLS DHE TAISUKE NAKATA, REZERVA FEDERALE

Autorët e këtij studimi gjejnë se prezenca e vonesave kohore të normës bazë së politikës monetare në rregullin e feedback-ut të normës së interesit e redukton multiplikatorin e shpenzimeve qeveritare në mënyrë të ndjeshme, kur norma e politikës monetare është në kufirin e poshtëm zero. Në një ekonomi që karakterizohet nga inercia e politikës, një nivel më i lartë i inflacionit dhe i rritjes ekonomike, për shkak të shpenzimeve qeveritare më të larta gjatë një recesioni, e përshpejton kthimin e normës bazë të politikës monetare drejt gjendjes së qëndrueshme, pasi mbaron recesioni. Kjo do të çojë në zbutjen e efekteve ekspansioniste të shpenzimeve qeveritare gjatë recesionit nëpërmjet pritshmërive. Në kalibrimin e baseline-it, multiplikatori i prodhimit në kufirin e poshtëm zero është 2.5, kur pesha e vonesës kohore të normës bazë është zero, dhe 1.1 kur kjo peshë është 0.9.

http://www.federalreserve.gov/econresdata/feds/2014/files/2014107pap.pdf

"EFEKTET MAKROEKONOMIKE TË POLITIKAVE MONETARE JOKONVENCIONALE TË REZERVËS FEDERALE", NGA ERIC M. ENGEN, THOMAS T. LAUBACH DHE DAVID REIFSCHNEIDER, REZERVA FEDERALE

Duke përdorur makromodelin e Rezervës Federale (FRB/US), autorët synojnë të vlerësojnë impaktin e politikave jokonvencionale në ekonominë amerikane. Studimi përdor të dhëna nga anketa "Blue Chip Economic Indicators" për të përfaqësuar perceptimet e sektorit privat mbi rregullin implicit të politikës monetare që do të ndiqte Rezerva Federale pasi të ishte larguar nga kufiri i poshtëm zero, dhe vlerësime të përftuara nga studime të tjera rreth efekteve të programeve të lehtësimit sasior në primet me afat. Studimi gjen se impakti neto në inflacion dhe në aktivitetin real është i kufizuar, për shkak të natyrës graduale të ndryshimit në pritshmëritë e sjelljes së politikës apo në efektet e primeve me afat, si dhe për shkak të një besimi persistent nga ana e publikut, që ritmi i rimëkëmbjes ekonomike do të ishte më i shpejtë se ç 'rezultoi. Sipas studimit, efekti maksimal në papunësi nuk do të arrihej deri në fillim të vitit 2015, ndërsa efekti maksimal në inflacioni nuk pritet të ndodhë para vitit 2016.

http://www.federalreserve.gov/econresdata/feds/2015/files/2015005pap.pdf

"SHKAQET DHE PASOJAT E PABARAZISË SË TË ARDHURAVE: NJË PERSPEKTIVË GLOBALE", NGA ERDA DABLA-NORRIS, KALPAN KOCHHAR, NUJIN SUPHAPHIPHAT, FRANTISEK RICKA DHE EVRIDIKI TSOUNTA, FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Qëllimi i këtij studimi është, së pari, të tregojë pse është e nevojshme që politikëbërësit të fokusohen në klasën e varfër dhe të mesme. Analiza sugjeron se shpërndarja e të ardhurave është e rëndësishme për rritjen ekonomike. Në mënyrë më specifike, nëse pjesa e të ardhurave të 20%-shit të sipërm (ta pasurit) rritet, rritja ekonomike do të ngadalësohet në afatin e mesëm, duke sugjeruar që fitimet e të pasurve nuk rrjedhin poshtë. Në të kundërt, një rritje në pjesën e të ardhurave të 20%-shit të poshtëm (të varfërit) do të rritet, rritja ekonomike do të përshpejtohet.

Së dyti, analiza shpjegon tendencat divergjente në zhvillimet e pabarazisë ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, me fokus të veçantë në klasën e varfër dhe të mesme. Analiza sugjeron se progresi teknologjik dhe rritja në primin e aftësive, si dhe rënia e disa institucioneve të tregut të punës kanë kontribuar në rritjen e pabarazisë në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim.

http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2015/sdn1513.pdf

"PAVARËSIA E POLITIKËS MONETARE NËN REGJIMIN FLEKSIBËL TË KURSIT TË KËMBIMIT: NJË ILUZION?", NGA SEBASTIAN EDWARDS, ZYRA KOMBËTARE PËR KËRKIMIN EKONOMIK (NBER)

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nëse vendet me regjim fleksibël të kursit të këmbimit janë në gjendje të ndjekin një politikë monetare të pavarur, ashtu siç sugjeron teoria tradicionale. Studimi përdor të dhëna për tre vende të Amerikës Latine me kurs fleksibël të këmbimit, me regjim të shënjestruar të inflacionit dhe me lëvizshmëri të kapitalit: Kili, Kolumbia dhe Meksika; me synim investigimin e shkallës me të cilën veprimet e Rezervës Federale reflektohen në normat bazë të

politikës monetare të bankave qendrore. Gjetjet tregojnë se ka një sjellje ngjitëse të politikës dhe që vendet kanë tendencën të importojnë politikat e Rezervës Federale. Shkalla e pavarësisë së politikës monetare është më e ulët se ajo që sugjerojnë modelet tradicionale.

http://www.nber.org/papers/w20893.pdf

V. AKTIVITETE TË TJERA

SEMINARE TEKNIKE

Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon brenda departamentit, seminare teknike dhe/ose seminare me karakter informativ mbi çështje, dukuri apo fenomene të ndryshme me interes. Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të seminareve të zhvilluara gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2015.

"NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI EKONOMIKSIN E SJELLJES", NGA ALTIN TANKU, ENDRIT YZEIRAJ, MARGERITA TOPALLI DHE ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky seminar kishte për qëllim një prezantim të parë të përgjithshëm mbi ekonomiksin e sjelljes, (behavioral economics) që është një nga fushat e reja kërkimore ku po bazohet gjithmonë e më shumë shkenca e ekonomisë. Ai u fokusua kryesisht mbi modelet kryesore që janë përdorur për të përfaqësuar sjelljet joracionale të agjentëve ekonomikë. Ajo që vihet re nga literatura është se nuk ka një standard të gjithëpranuar për modelimin e sjelljeve joracionale. Akoma më shumë, studime që fokusohen në çështje specifike të ekonomisë kanë për detyrë modelimin e sjelljeve joracionale të shkaktuara për arsye të ndryshme. Përdorimi i studimeve nga fusha e psikologjisë dhe krijimi i eksperimenteve për të kuptuar më mirë sjelljen e agjentëve janë dy nga pikat mbi të cilat studiuesit e ekonomiksit të sjelljes po punojnë aktualisht. Studimet dhe modelet e ekonomistëve, përfshirë dhe ato mbi rastin e Shqipërisë, gjithsesi nuk mund t'i shpëtojnë faktit se ekonomia reale shumë rrallë është rezultat i sjelljeve tërësisht racionale.

"TABELAT SAM TË SHQIPËRISË: STRUKTURA DHE MULTIPLIKATORËT", NGA ENIAN ÇELA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Tabelat e kontabilitetit social përfshijnë tërësinë e transaksioneve në ekonomi gjatë një viti. Në rastin e Shqipërisë, tabelat e burimeve, përdorimeve dhe input-output përfshijnë në terma nominale transaksionet e viteve 2009-2013. Përmes procedurës standard janë llogaritur multiplikatorët e prodhimit, të ardhurave, importeve dhe produktit të brendshëm për 25 sektorët e përfshirë

në statistika. Të njëjtët multiplikatorë janë llogaritur për komponentët e kërkesës agregate. Së fundi, janë përshkruar disa nga karakteristikat e përgjithshme dhe disa risqe strukturore sipas këtyre statistikave për ekonominë tonë.

"NJË RREGULL FISKAL NË MAKROMODELIN MEAM", NGA LORENA SKUFI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij seminari ishte të prezantonte implementimin e një rregulli fiskal në makromodelin MEAM, i cili do të mundësonte adresimin e saktë të çështjeve të politikës fiskale dhe vlerësimin e ndikimit të tejkalimit të limiteve fiskale në ekonomi. Seminari u ndal në përshkrimin e llojeve të ndryshme të rregullave fiskale, si dhe të rregullit fiskal të implementuar në modelin MEAM. Së fundi, u paraqitën rezultatet e simulimit të modelit me dhe pa rregullin fiskal, si dhe krahasimi midis tyre.

"PËRÇIMI I NORMËS SË INTERESIT NË SHQIPËRI", NGA ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Në këtë seminar u prezantuan rezultatet paraprake të materialit studimor, i cili synon të hulumtojë përçimin e normës së interesit, nga norma bazë tek normat e tregut ndërbankar primar, dhe normat e tregut me pakicë (kredi dhe depozita), për periudhën 2002M01:2014M06. Kuptimi i procesit të përçimit të normës së interesit është i rëndësishëm për një bankë qendrore, sepse magnituda dhe shpejtësia e tij do të përcaktojnë eficiencën e transmisionit të politikës monetare. Rezultatet paraprake tregojnë së reagimi i normave të tregut ndërbankar dhe primar ndaj impulseve të politikës monetare është i lartë, i rëndësishëm statistikisht, si dhe relativisht i shpejtë. Reagimi i normave të interesit të kredisë dhe depozitave është i ndjeshëm ndaj periudhës kohore të përdorur për vlerësim empirik.

"PËRCAKTUESIT MIKRO DHE MAKROEKONOMIKË TË MARZHIT BANKAR NË SHQIPËRI (2002-2014)", NGA ERALDA LEKA, DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, MERI PAPAVANGJELI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Gjatë seminarit u shpjegua metodologjia e përdorur për të bërë një analizë të treguesve të përfshirë në model dhe u prezantuan rezultatet e punës paraprake. Vëmendja u përqendrua tek treguesit makroekonomikë, të tillë si: norma e rritjes reale ekonomike, inflacioni, kursi i këmbimit, norma bazë e interesit dhe euribori; përfshirja e të cilave përbën një ndër risitë e këtij punimi. Rezultatet paraprake sugjerojnë se këta tregues kanë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes së marzhit bankar në Shqipëri. Megjithatë, analiza e mëtejshme do të japë rezultate më të sakta lidhur me këtë çështje.

PROGRAMI I ASISTENCËS PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR BANKAT QENDRORE

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Programin e Asistencës për Ngritjen e Kapaciteteve për Bankat Qendrore (BCC), Prof. Thorsten Beck, në datat 19-21 maj dhe 25-27 maj 2015, mbajti një seminar mbi **"Instrumentet e Politikës Makroprudenciale"**. Profesori Thorsten Beck, aktualisht profesor i banking-ut dhe financës në

Cass Business School në Londër, është një figurë e shquar e kërkimit shkencor rreth çështjeve të lidhura me marrëdhënien ndërmjet financës dhe zhvillimit ekonomik e politikave që duhen ndjekur për të ndërtuar një sistem financiar efektiv dhe të shëndoshë. Qëllimi i këtij seminari ishte të ofronte një përshkrim të koncepteve teorike dhe empirike mbi stabilitetin financiar, matjeve të ndryshme të tij, të instrumenteve makroprudenciale dhe të rëndësisë së banking-ut ndërkufitar, ndërlidhjeve dhe rolit të bashkimit bankar në kontekstin shqiptar. Pjesa e dytë e seminarit u fokusua në ndërlidhjen e politikës monetare me atë makroprudenciale, në ndërlidhjen e konkurrencës e stabilitetit bankar, si dhe në matjen e rrezikut sistemik.

Seminari i dytë i organizuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 ishte **"Vlerësimi i Modeleve DSGE"**, me lektor Dr. Refet Gürkaynak. Ky aktivitet u organizua në kuadër të punës së Departamentit të Kërkimeve për ndërtimin e një modeli DSGE dhe kishte si pikësynim vazhdimin e punës teorike të nisur në seminarin e qershorit 2014 (2-6 qershor 2014), me lektore Celine Poilly (me temë "Designing DSGE Models") për të propozuar një model DSGE me të dhënat e ekonomisë shqiptare. Porf. Gürkaynak trajtoi kuadrin teorik të modeleve DSGE dhe rolin e tyre në shpjegimin e dukurive ekonomike. Në ditën e fundit të seminarit, u shpjegua strukturimi dhe hedhja e një modeli të thjeshtuar DSGE në programin DYNARE.

LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA

Banca d'Italia
(http://www.bancaditalia.it/studiricerche)

Banco de Espana
(http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm)

Bank of England
(http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm)

Bank of Finland
(http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm)

Bank of Greece
(http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp)
Czech National Bank
(http://www.cnb.cz/en/research/))

Deutsche Bundesbank
(http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php)

European Central Bank
(http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html)
Oesterreichische Nationalbank
(http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp)

Federal Reserve
(http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm)

BIS Central Bank Research Hub
(http://www.bis.org/cbhub/index.htm)

International Journal of Central Banking
(http://www.ijcb.org/)

National Bureau of Economic Research
(http://www.nber.org/)

International Monetary Fund
(http://www.imf.org/external/pubind.htm)